



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**DREJTORIA PLANIFIKIMT E KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**  
**SEKTORI I MBROJTJES SË MJEDISIT**

**NJOFTIM**

Bashkia Durrës, si organ i Pushtetit Vendor me Nr. K42006501R Nipt në zbatim të ligjit Nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor” dhe VKM nr. 219 datë 11.03.2015 “Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor” ju bën me dije se organizon konsultën me grupet e interesit ne platformen zoom, si pjesë përbërëse e procedurës së VSM-së për PPV-në.

Objektivi i VSM-së është të përcaktojë, të përshkruajë dhe vlerësojë të gjitha ndikimet negative domethënëse në mjedis, që mund të vijnë nga zbatimi i planit apo programit, dhe sigurimi i një alternative më të favorshme nga perspektiva mjedisore. Proçesi i vlerësimit strategjik mjedisor në të cilin ka kaluar dhe PPV, artikullohet në stadet që vijojnë më poshtë:

- a. njoftimi i Ministrisë nga autoriteti propozues;
- b. konsultimi me palët e interesuara për çështjet që duhet të përballen në raportin mjedisor;
- c. redaktimi i raportit paraprak dhe konsultimi me palët e interesuara dhe publikun në lidhje me të;
- d. redaktimi i raportit final të Vlerësimit Strategjik Mjedisor;
- e. verifikimi i relacionit dhe deklaratës së Ministrit;
- f. vendimi i autoritetit miratues; monitorimi
- g. sinjalizimi i ndikimeve mjedisore të planit apo programit

Bashkia Durrës në zbatim të ligjit Nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor” ka aplikuar pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit në shkresat me Nr. 8969 prot. datë 22.08.2016 dhe Nr. 5269 prot. datë 30.03.2017, për nisjen e procedurës për VSM-së të PPV-së. Vizioni strategjik për Durrësin bazohet në mundësinë e intensifikimit të zhvillimit urban, duke ruajtur trashëgiminë dhe resurset natyrore, të cilat kjo NJQV i ka me bollëk. Durrësi është i përbërë nga elementë të mirëpërcaktuar dhe lehtësisht të identifikueshëm, siç është porti, qendra historike, zona rezidenciale përreth stadiumit, zona rezidenciale përgjatë pjesës jugore të rivierës dhe vendbanimet e Kënetës e Spitalës. Ndërkohë që këto pjesë të qytetit identifikohen lehtësisht, bashkë me rrethinat e tyre dhe me zonat joformale, ju mungon

akoma një përcaktim i mirëfilltë. Vizioni i propozuar në plan konsiston në dhënien e qytetit e një strukture që është lehtësisht e lexueshme në çdo pjesë të saj, duke përfunduar identitetin urban dhe duke shmangur një shtrirje të mëtejshme të ndërtimeve në drejtim të zonave bujqësore përreth. Duke parë se qyteti paraqet shumë hapësira të lira dhe një numër të lartë ndërtesash të pashfrytëzuara, propozohet një vendosje urbane që konsiston në shfrytëzimin e hapësirave boshe dhe rikuperimin e strukturave të papërfunduara. Planit parashikon një seri masash vepruese strategjike, si hapja graduale e portit ndaj publikut dhe zhvendosja e portit industrial në Porto Romano, restaurimi i trashëgimisë kryesore historike, siç është kështjella dhe amfiteatri antik, ndërtimi dhe rikuperimi i strukturave të vjetra publike si shkolla, kopshte, parqe lojrash dhe hapësira publike.

Objektivat strategjik të identifikuar nga plani territorial për Durrësin janë:

1. Ristrukturimi dhe rehabilitimi i qendrave urbane dhe rurale;
2. Vlerësimi dhe ruajtja e monumenteve të trashëgimisë kulturore;
3. Garantimi i aksesit në shërbimet sociale dhe kolektive;
4. Përmirësimi i nevojave për banesa dhe përmirësimi i ofertave për strehim;
5. Implementimi i poleve të reja ekonomike, tregtare dhe zonave të prodhimit;
6. Përmirësimi dhe implementimi i infrastrukturave bazë urbane;
7. Përforsimi i rrjetit të transportit publik dhe i qarkullimit të ngadaltë;
8. Përmirësimi i transportit në rrugë;
9. Përcaktim i ri i portit;
10. Zgjidhja e problematikave kryesore mjedisore siç është erozioni, shkarjet e tokës dhe përmbytjet;
11. Vlerësimi dhe ruajtja e elementëve cilësor mjedisor.
12. Përmirësimi i agrikulturës duke qenë aktiviteti kryesor ekonomik i territorit;
13. Implementimi i sistemit të parqeve territoriale.

Masat vepruese korresponduese me objektivat të lartëpërmendura ndërthuren për të gjithë sektorët që do të ndërhyhet (përkatsisht: sistemi urban, infrastrukturor, resurset hidrike, natyra dhe agrikultura). Qëllimi i përgjithshëm i realizimit të procesit të VSM-së është ndërthurja e kërkesave mjedisore në përgatitjet e planifikimit dhe procesin e vendimmarrjes, në përmirësimin e planit, që bëjnë të mundur mbrojtjen e mjedisit sikurse edhe rritja e pjesëmarrjes së komunitetit (publikut) në procesin e vendimmarrjes me mjedisin. Kjo u pasqyrua dhe me organizimin nga ana e Institucionit Tonë të 3 Dëgjësave Publike në datat 09.09.2016; 15.02.2017 dhe 12.06.2017 me publikun dhe grupet e interesit në zbatim të VKM-së nr. 219 datë 11.03.2015 "Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor".

Raporti i VSM-së i ka kushtuar një vëmendje studimit të parametrave të ndryshëm mjedisor dhe efekteve të tyre, veçanërisht parametrat natyrorë dhe shëndetësor si:

- biodiversiteti
- zonat e mbrojtura dhe të veçanta mjedisore
- pasuri ujore
- tokës
- klimës dhe cilësisë së ajrit
- ndotjes dhe cilësisë së ajrit
- menaxhimit të mbetjeve dhe infrastrukturës mjedisore
- strukturën hapsinore të përdorimit të tokës dhe elementet infrastrukturore përkatëse
- pejsazhin dhe trashgiminë kulturore
- profilin social ekonomik dhe zhvillimet prespektive të degëve të veçanta ekonomisë

Ai ka analizuar planin urbanistik duke vlerësuar impaktin e zhvillimeve të dala nga ky plan, masat parandaluese për mbrojtjen e mjedisit, si dhe vlerësimin e sistemeve të monitorimit. Në fund të procesit është pajisur me Deklaratë Mjedisore me Nr. 1310/1 prot. datë 12.12.2017. Duke qenë se Plan i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Durrës nuk është miratuar ende, për rrjedhojë mbështetur në nenin 12 Shqyrtimi dhe Deklarata e Ministrit Pika 9. "... Nëse plani apo programi nuk është miratuar sipas parashikimeve të nenit 13, brënda 2 viteve nga data e miratimit të deklaratës, atëherë deklarata bëhet e pavlefshme dhe procedura e VSM-së fillon nga e para.." nw vijim Bashkia Durrës ka ri-nisur procedurën e VSM për PPV-në duke rikryer pagesën me datë 15.02.2021.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

**ZËVENDËSKRYETAR**

**Emiriana Sako**

